



UNIVERSITETI "UKSHIN HOTI" PRIZREN
UNIVERSITY "UKSHIN HOTI" PRIZREN

BULETINI

I REFERATEVE TË KANDIDATËVE TË PARAQITUR NË
KONKURSIN Nr. 01-18 TË DATËS 19.01.2018
PËR ZGJEDHJEN E PERSONELIT AKADEMIK

Fakulteti i SHKENCAVE TË JETËS DHE MJEDISIT

1. Referat për zgjedhjen e një (1) mësimdhënës për lëndët: Dendrometri, Agropylltari, Administrimi dhe Politikat e Resurseve Pyjore dhe Planifikimi i Menaxhimit të Pyjeve.

Kandidatët:

1. Dr. sc. Faruk Bojaxhi;



RAPORT I KOMISIONIT RECENSUES PËR ZGJEDHJEN E STAFIT AKADEMIK

Fakulteti: **Shkencave të Jetës dhe Mjedisit**

Lënda/ët: **Një mësimdhënës për lëndët: Dendrometri, Agropylltari, Administrimi dhe Politikat e Resurseve Pyjore dhe Planifikimi i Menaxhimit të Pyjeve.**

Kandidatët e paraqitur në Konkursin e datës 19.01.2018, nr. ref.: 01-18/A

1. Dr. sc. Faruk Bojaxhi

Komisioni recensues:

- | | |
|------------|-------------------------------|
| 1. Kryetar | Prof. Ass. Dr. Bekim Gashi |
| 2. Anëtar | Prof. Ass. Dr. Albana Milaimi |
| 3. Anëtar | Prof. Ass. Dr. Ylli Kortoçi |

Raporti i recensionit:

Fakulteti: **Shkencave të Jetës dhe Mjedisit**

Lënda/ët: Një mësimdhënës për lëndët: Dendrometri, Agropylltari, Administrimi dhe Politikat e Resurseve Pyjore dhe Planifikimi i Menaxhimit të Pyjeve.

Të dhënat mbi kandidatin

Emri dhe mbiemri: **Faruk Bojaxhi**

Datëlindja dhe vendlindja: **26.9.1976, Pllavë**

Gradat shkencore: **Doktor i Shkencave në lëmin e Pyjeve** (vendimi i njohjes nga MASHT, nr. 6-365, datë 23.01.2018)

Departamenti/fakulteti: **Fakulteti i Shkencave Pyjore**

Universiteti: **Universiteti Bujqësor i Tiranës**

Titujt akademikë: **ligjerues i angazhuar në Fakultetin e Shkencave të Jetës dhe Mjedisit në Universitetin Ukshin Hoti në Prizren si dhe Fakulteti i Shkencave Pyjore në Universitetin Bujqësor të Tiranës.**

Viti kur është fituar titulli aktual: **2012-2018**

1. Përmbledhje e aktivitetit shkencor

Kontributi shkencor i kandidatit

(Në këtë pjesë të raportit përshkruhen publikimet më të rëndësishme duke u bazuar në CV e kandidatit)

Tabela 1. Përmbledhje e kategorive dhe numrit të përgjithshëm të punimeve shkencore të kandidatit, të cilat tregojnë origjinalitetin dhe ndikimin e punës së tij shkencore

Veprimtaria shkencore e kandidatit	Prej fillimit të karrierës	Gjatë 4 vjetëve të fundit
Numri i publikimeve në revistat me "impact faktor" si autor kryesor *	-	-
Numri i publikimeve në revistat me "impact faktor" si koautor **	-	-
Numri i publikimeve në revistat ndërkombëtare pa "impact faktor" si autor kryesor * dhe sipas nenit 3 të Udhëzimit Administrativ të MASHT UA 01-2018	3	3
Numri i publikimeve në revistat ndërkombëtare pa "impact faktor" si koautor ** dhe sipas nenit 3 të Udhëzimit Administrativ të MASHT UA 01-2018	1	1
Numri i publikimeve në kongreset ndërkombëtare në formë të "proceedings" si autor kryesor ose si koautor	1	-
Numri i publikimeve në revista të tjera (të publikuara në Kosovë ose në rajon)	-	-
Numri i ligjëratave gojore shkencore në konferenca dhe në universitete (si ligjërues i ftuar)	-	-
Numri i abstrakteve nga konferencat shkencore ndërkombëtare si autor kryesor dhe si koautor	1	-
Numri i librave ose monografive të botuara si autor kryesor në gjuhë të huaja	-	-
Numri i librave ose monografive të botuara si autor kryesor në gjuhën shqipe	-	-
Numri i librave ose monografive të botuara si koautor	-	-
Kontribute të tjera shkencore dhe artistike	-	-
-	-	-

Vërejtje lidhur me tabelën 1:

***Autor kryesor** konsiderohet personi, emri i të cilit gjendet i pari në listën e autorëve (ose që është i evidentuar si autor korrespondent). Autori kryesor konsiderohet ai, i cili ka dhënë idenë për punën shkencore dhe që e bart barrën kryesore për finalizimin e punimit shkencor.

****Koautorë** konsiderohen personat të cilët kanë kontribuar në punën eksperimentale ose në përgatitjen e punimit për publikim.

Punimet relevante të kandidatit

(Në këtë pjesë të raportit përshkruhen në mënyrë të detajuar publikimet në bazë të të cilave bëhet zgjedhja/avancimi i kandidatit sidhe rëndësia e tyre dhe ndërlidhja me lëndët për të cilat zgjedhet/avancohet kandidati/ja)

Tabela 2. Punimet shkencore të kandidatit të cilat tregojnë origjinalitetin, ndikimin shkencor dhe citimin e publikimit në nivel ndërkombëtar

Të dhënat për punimet: Autorët / Titulli / Revista / Vëllimi / Numri / Faqet	"Impact factor"	Nr. i citimeve	Indeksuar sipas, nenit 3 të UA 01-2018
/	/	/	
Të dhënat për punimet: Autorët / Titulli / Revista / Vëllimi / Numri / Faqet	pa "Impact factor"	Nr. i citimeve	Indeksuar sipas, nenit 3 të UA 01-2018
1. Faruk Bojaxhi , Elvin Toromani (2017): Spatial and temporal variation in Bosnian pine (<i>Pinus heldreichii</i> Christ.) growth due to climate in Kosovo. <i>International Journal of Development and Sustainability</i> , 6(1): 1-15. https://doaj.org/article/f7b5e835b67a4a51a008342485a5b9aa	/	/	DOAJ
2. Faruk Bojaxhi , Elvin Toromani (2017): Spatial and Temporal Growth Variation of <i>Pinus heldreichii</i> Christ. Growing along a Latitudinal Gradient in Kosovo and Albania. <i>South-East European Forestry</i> , 8(2). https://www.worldcat.org/title/spatial-and-temporal-growth-variation-of-pinus-heldreichii-christ-growing-along-a-latitudinal-gradient-in-kosovo-and-albania/oclc/7113167880&referer=brief_results https://doaj.org/article/f7b5e835b67a4a51a008342485a5b9aa			WorldCat; DOAJ
3. Faruk Bojaxhi , Elvin Toromani (2016): The Growth of Bosnian Pine (<i>Pinus heldreichii</i> Christ.) at Tree-Line Locations from Kosovo and its Response to Climate. <i>South-East European Forestry</i> , 7(2): 109-118. https://www.worldcat.org/title/the-growth-of-bosnian-pine-pinus-heldreichii-christ-at-tree-line-locations-from-kosovo-and-its-response-to-climate/oclc/7181189697&referer=brief_results https://doaj.org/article/4b971a5d1bdc4e77ad04da93b09e1913	/	/	WorldCat; DOAJ
4. Elvin Toromani, Faruk Bojaxhi (2010): Growth response of Silver fir (<i>Abies alba</i> Mill) and Bosnian pine (<i>Pinus heldreichii</i> Christ) from Kosovo. <i>South-East European Forestry</i> , 1(1): 20-27. https://www.worldcat.org/title/growth-response-of-silver-fir-and-bosnian-pine-from-kosovo/oclc/7181162553&referer=brief_results https://doaj.org/article/7d5ad07f6226445b9313a00f748a4809	/	/	WorldCat; DOAJ

Të dhënat për punimet tjera: Proceedings			
1. Faruk Bojaxhi , Elvin Toromani (2016): Spatial and temporal variation in Pinus hedreichii growth at three line locations in Kosovo. Proceedings Book of 6 th International Conference of Ecosystems, Tirana, Albania.			
Të dhënat për punimet tjera: Kumtesat shkencore			
1. Faruk Bojaxhi , Elvin Toromani (2016): Spatial and temporal variation in Pinus hedreichii growth at three line locations in Kosovo. TRACE, Bialowieza, Poland.			

Shënim: Në bazë të kërkimeve në listat e publikimeve të botuesve apo revistave të dyshimta rezultoi se asnjëra nga revistat ku ka botuar kandidatit Faruk Bojaxhi nuk janë të përfshira në këto lista të dyshimta sipas nenit 3 paragrafi 5 i udhëzimit administrativ të MASHT 01-2018 për parimet e njohjes së platformave dhe revistave ndërkombëtare!

2. Përvoja në mësimdhënie universitare

1. Në këtë pjesë të raportit shënohen gradat paraprake shkencore dhe titujt akademikë të kandidatit, si universitetet ku ka punuar ai, sidhe aktivitetet mësimore dhe profesionale;
2. Me rastin e zgjedhjes/rizgjedhjes së asistentëve në Fakultetin e Mjekësisë përparësi kanë kandidatët që vijnë/kanë specializimin nga lëmia përkatëse ku konkurrojnë.

- Mars 2012 – Korrik 2017 (pesë vite akademike)

ka qenë i angazhuar në aktivitet e mësimdhënjes për lëndët Dendrometri (Bsc.) dhe Dendronologji (Msc.) pranë Fakultetit të Shkencave Pyjore, Universiteti Bujqësor i Tiranës (Vërtetim i lëshuar nga Dekani Leonidha Peri, Nr. 88 datë 28.7.2017).

- Tetor 2017 – aktualisht, ligjerues i angazhuar për lëndën Dendrometri dhe Agropylltari ne Fakultetin e Shkencave të Jetës dhe Mjedisit, Universitetin Ukshin Hoti në Prizren.

3. Përgjegjësitë për aktivitetet në shërbim të njësisë akademike dhe udhëheqja në hulumtim

(Në këtë pjesë të raportit shënohen pozitat dhe funksionet udhëheqëse, aktivitetet në lidhje me zhvillimin profesional si dhe projektet shkencore të realizuara nga kandidati)

Nga viti 2002-2009 ka punuar si inxhinier përgjegjës në Agjencionin Pyjor të Kosovës në Prizren. Nga viti 2009-2010 ka qenë U.D i Drejtorit të Drejtorise Koordinuese të Agjencisë Pyjore të Kosovës, Drejtoria Koordinuese në Prizren. Gjate periudhes 2010-2013 ka punuar si Drejtor i Drejtorise Koordinuese të Agjencionit Pyjor të Kosovës Drejtoria në Prizren. Nga viti 2013 është emruar në pozitën Drejtor i Drejtorisë për Menaxhim me Pyje në AKP, Ministria e Bujqësisë, Pyllatrisë dhe Zhvillimit rural.

Kandidati Faruk Bojaxhi ka një eksperiencë mjaft të gjatë dhe të bujshme në lëmin e shkencave pyjore si me pjesëmarrje në projekte, trajnime, grupe punuese, etj., me ç'rast për këto qëllime ka qendruar në vende të ndryshme si: Skoci, Itali, Austri, Bullgari, Gjeorgji, Turqi, Gjermani, Hungari, Shqipëri, etj.

Në dosjen e tij ka deponuar edhe disa certifikata në lidhje me trajnime dhe pjesëmarrje të ndryshme profesionale në lëmin e pyjeve dhe njohjes së gjuhës Angleze.

4. Mobiliteti i kandidatit

(Në këtë pjesë të raportit shënohen universitetet në të cilat ka studiuar kandidati, si dhe institucionet e tjera në të cilat ka qëndruar për qëllime pedagogjike shkencore)

Kandidati Faruk Bojaxhi në vitin 2017 ka përfunduar studimet e doktoraturës në Fakultetin e Shkencave Pyjore pranë Universitetit Bujqësor të Tiranës, ku dhe fitoi gradën: **Doktor i Shkencave në lëmin e Pyjeve** (vendimi i njohjes nga MASHT, nr. 6-365, datë 23.01.2018). Nga viti 2006-2009 ka ndjekur studimet pasuniversitare në Fakultetin e Shkencave Pyjore pranë Universitetit Bujqësor të Tiranës, ku dhe me përfundimin e tyre mori gradën **Master në Shkencat Pyjore në drejtimin Qeverisje Ekologjike e Pyjeve** (vendimi i njohjes nga MASHT, nr. 228/2010, datë 01.06.2010). Nga viti 1996 – 2001 ka ndjekur studimet themelore (4 vjeçare) në Fakultetin e Shkencave Pyjore pranë Universitetit Bujqësor të Tiranës, ku dhe fitoi gradën: **Inxhinier në përpunimin e drurit** (vendimi i njohjes nga MASHT, nr. 6-568, datë 09.3.2017).

5. Titulli i cili propozohet (për të gjithë kandidatët)

(Anëtarët e Komisionit recensues janë të obliguar që të shkruajnë një arsyetim të detajuar lidhur me titullin i cili propozohet. Ata janë të obliguar që të paraqesin në mënyrë të qartë arsyet e bazuara në Statut dhe në Konkurs dhe përse kandidati i përzgjedhur e meriton më shumë se të tjeret që të propozohet).

Kandidati **Dr. sc. Faruk Bojaxhi** i plotëson kriteret për zgjedhje në thirrjen akademike **Profesor Asistent:**

- e ka gradën e Doktor i Shkencave Pyjore të fituar në vitin 2017,
- e plotëson në përpikëmi profilin akademik me lëndët ku ka konkurruar,
- ka publikuar **3** punime shkencore si autor i kryesor në revista shkencore ndërkombëtare (të indeksuara në WorldCat dhe DOAJ sipas nenit 3 paragrafi 1 i UA të MASHT 01-2018),
- ka publikuar **1** punim shkencor si koautor në revista shkencore ndërkombëtare,
- ka marrë pjesë në **2** konferenca ndërkombëtare si autor dhe koautor,
- ka përvujtë e mjaftueshme në mësimdhënien universitare (më shumë se **5 vite**),
- ka marrë pjesë aktivisht në trajnime, specializime dhe projekte profesionale-shkencore në vendet e ndryshme të BE-së,
- ka përvujtë punë mjaft të gjatë në fushën e pyjeve,
- fletë, shkruan dhe lexon gjuhën Angleze.

Duke u bazuar në këto që cekëm më lartë dhe në bazë të kushteve të konkursit dhe nenit 173 të Statutit të Universitetit Ukshin Hoti në Prizren si dhe udhëzimit administrativ të MASHT 01-2018 për parimet e njohjes së platformave dhe revistave ndërkombëtare, kandidati Dr. sc. Faruk Bojaxhi i plotëson në tërësi të gjitha kushtet për tu zgjedhur në thirrjen Profesor Asistent, prandaj komisioni me kënaqësi të veçantë i propozon njëzëri senatit të UPZ-së që **Dr. sc. Faruk Bojaxhi ta zgjedh Profesor Asistent për lëndët: Dendrometri, Agropylltari, Administrimi dhe Politikat e Resurseve Pyjore dhe Planifikimi i Menaxhimit të Pyjeve,** në Fakultetin e Shkencave të Jetës dhe Mjedisit, Universiteti Ukshin Hoti në Prizren.

Komisioni recensues:

1. Kryetar Prof. Ass. Dr. Bekim Gashi



2. Anëtar Prof. Ass. Dr. Albana Milaimi



3. Anëtar Prof. Ass. Dr. Ylli Kortoçi

